



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/458  
Datë: 15/6/2023

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të stimulimit dhe avansimit të fushës së botimeve për librat universitarë, në përputhje edhe me objektivat strategjike menaxheriale, bazuar në kushtet dhe kriteret e Rregullores për Publikime të Universitetit të Prishtinës nr.prot.2/283, datë 3/10.2013. Në mbledhjen e mbajtur më 8.6.2023 mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohen kriteret për thirrje për botimin e librave universitarë.
- II. Këshilli Drejtues i UP-së, duke e parë si interes për universitetin dhe stafin akademik të UP-së, aprovoi kriteret për thirrje për botimin e librave universitare, të cilat janë:
  - Pranohen dorëshkrime nga të gjitha fushat e studimeve shkencore dhe artistike. Përparësi botimi kanë dorëshkrimet, sidomos, për lëndët mësimore që nuk kanë tekst bazë universitar në gjuhën shqipe dhe që me plane dhe programe mësimore janë literaturë bazë;
  - Dorëshkrimet e teksteve duhet t'i përmbajnë arritjet profesionale, shkencore dhe artistike, në pajtim me kërkesat bashkëkohore metodologjike dhe pedagogjike;
  - Nuk pranohen dorëshkrime të teksteve të botuara më herët;
  - Autorë/bashkautorë të teksteve duhet të jenë mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune. Në raste të veçanta, dhe në fusha specifike, bashkautorë të teksteve mund të jenë edhe stafi i pensionuar i UP-së;
  - Paraprakisht, dorëshkrimin, bashkë me raportin e recensentëve, e miraton Këshilli i Njesisë Akademike;
  - Lejen dhe vendimin përfundimtar, në përputhje me kriteret dhe procedurat e Rregullores në fuqi, e jep Këshilli Botues i UP-së;
  - Dorëshkrimi duhet t'i nënshtrohet recensionit të së paku tre anëtarëve të fushës përkatëse, të cilët i cakton Këshilli i Njesisë Akademike. Dorëshkrimi duhet të ketë së paku dy vlerësime pozitive të recensentëve;
  - Dorëshkrimi duhet të jetë në pajtim me planin dhe programin mësimor për lëndën përkatëse;
  - Dorëshkrimet duhet të jenë të lekturuara dhe korrektuara;
  - Me rastin e aplikimit, autori-ja /bashkautorët, duhet ta nënshkruajnë deklaratë për origjinalitetin e punimit dhe përgjegjësitë e tjera;

- Një autor/e ka të drejtë të konkurrojë me vetëm një dorëshkrim brenda së njëjtës thirrje; - Kompensimi financiar për, honoraret për autorët, redaktorin, recensentët, lekturë dhe korrekturë, si dhe kompensimi nga mjetet e grumbulluara nga shitja, realizohen në bazë të nenit 13 të Rregullores në fuqi;
- Shuma financiare, e ndarë, për mbështetjen e botimeve për këtë vit, është 50.000 euro;
- Dorëshkrimet, bashkë me vlerësimin e recensentëve dhe vendimin e Këshillit të Njesisë Akadematike, në versionin e shtypur (lidhje e butë) dhe në versionin elektronik; duhet të dorëzohen në Rektorat (Zyra e Protokollit), me mbishkrimin “Për Këshillin Botues”, më së largu deri më **1 nëntor 2023**.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Vendimi t’u dërgohet:**

1. Arkivit të UP-së,
2. Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Zyrës për çështje akademike në UP,
6. Zyrës ligjore të UP-së,
7. Asistentes së KD-së



Këshilli Drejtues i UP-së

Altin Sahiti - kryesues